

**ENTI RREGULLATOR I UJIT**



## **SHOQËRIA RAJONALE UK DIBËR**

**ANALIZA E HUMBJEVE TË UJIT PËR VITIN 2022**

**Tiranë, 2023**

## **Bilanci i Ujit**

### **Analiza e Humbjeve te Ujit për Shoqërinë Rajonale Dibër**

#### ***I. Të Përgjithshme mbi Hartimin e Bilancit të Ujit***

ERRU harton çdo vit Raportin e Bilancit të Ujit për shoqëritë që operojnë në Sektorin Ujësjellës - Kanalizime. Ky raport merr një rëndësi të veçantë për një menaxhim racional të sektorit sepse trajton në mënyrë të veçantë treguesin e Ujit Pa të Ardhura, pra humbjet e ujit. Treguesi UPA lidhet ngushtësisht me cilësinë e shërbimeve që shoqëritë i ofrojnë konsumatorëve si edhe më qëndrueshmërinë financiare të tyre.

Organizimi i ri i shoqërive, në 15 shoqëri rajonale në sektorin UK, ka sjelle nevojën për një strukturim të ri të analizës mbi UPA dhe “Bilancin e Ujit” në tërësi. Analiza e humbjeve të ujit për çdo shoqëri rajonale kryhet duke analizuar fillimisht Bilancin e Ujit më vete për çdo njësi (ish shoqëri UK) që tashmë është nën administrimin e shoqërisë rajonale të krijuar dhe më pas analiza behet në mënyrë të integruar për shoqërinë rajonale në tërësi. Kjo qasje mundëson vënien në pah të problematikave individuale të çdo njësie të cilat duhet të kihen parasysh në të ardhmen për zgjidhjen apo përmirësimin e tyre.

Kjo analizë i vjen në ndihmë çdo shoqëri rajonale duke i mundësuar asaj që nëpërmjet analizës së komponentëve përbërës të Bilancit të Ujit, për çdo njësi dhe në tërësinë e shoqërisë rajonale, të njihet në mënyrë analitike me nivelin e humbjeve (UPA), të nën komponentëve të saj, arsyet e veçanta të nivelit të lartë të humbjeve të ujit, nevojën dhe mënyrën e monitorimit të humbjeve, problematikat e faturimit më matje dhe aforfe, si dhe rekomandimet që ERRU jep për çdo shoqëri UK për të realizuar përmirësimet e nevojshme në punën e tyre.

“Bilanci i Ujit” si një instrument mjaft i rëndësishëm në përmirësimin e treguesit kryesor të performancës UPA, duhet të hartohet më të dhëna sa më të sakta pasi hapat që do të ndërmerren për reduktimin e tij lidhen ngushtësisht edhe më qëndrueshmërinë financiare të shoqërisë.

Si model i hartimit të Bilancit të Ujit do të përdoret ai i IWA (Shoqërisë Ndërkombëtare të Shoqërive të Ujësjellësve).

Duke patur parasysh gjendjen teknike të sistemeve të furnizimit më ujë si mungesën e matësve në burim, mos organizim të rrjeteve shpërndarëse bazuar në konceptin e Zonave më Matje të Pavarura (DMA-të), mangësitë në mjetet dhe metodat e monitorimit të konsumit, është vendosur që si metodologji e llogaritjes së nën komponentëve të Bilancit të Ujit të përdoret ajo nga “lart-poshtë” (top-down), ku fokusi kryesor në llogaritjen e humbjeve totale është përcaktimi i humbjeve të dukshme, dhe më tej përcaktohen ato reale.

#### ***II. Analiza e Uji Pa të Ardhura (UPA) për Shoqërinë Rajonale UK Dibër***

Shoqëria rajonale UK Dibër përbëhet nga ish shoqëritë UK ose Njësitë, përkatësisht UK Dibër, UK Mat, UK Bulqizë dhe UK Klos.

Të dhëna të përgjithshme në lidhje me popullsinë e shërbyer, konsumin për banor me matje dhe pa matje në të gjithë zonën e shërbimit të Sh. R UK Dibër jepen në **tabelën 1**.

Nga të dhënat e Tabelës 1, probleme të faturimit me matje nuk kanë asnjë nga ish shoqëritë e shoqërisë Rajonale UK Dibër. Problem me faturimin aforfe rezultoi për ish shoqërinë Klos, e cila ka konsum ditor 164.2 l/ditë, banor, që duhet të analizojë arsyet e mbi faturimit aforfe (nëse përfshijnë në të dhe klientët jo aktivë), sepse dihet që konsumi mesatar për banor për këtë lloj faturimi referuar VKM nr.102, datë 16.03.1992 duhet të jetë 150 litra/ditë.

**Tabela Nr. 1** Konsumi i Faturuar për Konsumatorët Familjare me Matje dhe Aforfe

| Sh. R UK Dibër | Popullsia e Shërbyer | Konsumi Total (në m <sup>3</sup> ) | Konsumi i Matur (në m <sup>3</sup> ) | Konsumi Pamatur (në m <sup>3</sup> ) | Lidhjet me matës | Lidhjet pa matës | Konsumi (l/ditë, banor) |                |               |
|----------------|----------------------|------------------------------------|--------------------------------------|--------------------------------------|------------------|------------------|-------------------------|----------------|---------------|
|                |                      |                                    |                                      |                                      |                  |                  | Konsumi i matur         | Konsumi aforfe | Konsumi Total |
| <b>Dibër</b>   | 28,463               | 1,315,500                          | 883,500                              | 432,000                              | 5,735            | 3,921            | 143.2                   | 102.4          | 126.6         |
| <b>Mat</b>     | 18,660               | 743,000                            | 456,000                              | 287,000                              | 4,077            | 1,996            | 99.7                    | 128.2          | 109.1         |
| <b>Bulqizë</b> | 18,000               | 832,400                            | 207,500                              | 624,900                              | 1,337            | 4,069            | 127.7                   | 126.4          | 126.7         |
| <b>Klos</b>    | 6,054                | 318,000                            | 146,000                              | 172,000                              | 1,039            | 936              | 125.6                   | 164.2          | 143.9         |
| <b>Totali</b>  | <b>71,177</b>        | <b>3,208,900</b>                   | <b>1,693,000</b>                     | <b>1,515,900</b>                     | <b>12,188</b>    | <b>10,922</b>    | <b>123.6</b>            | <b>123.5</b>   | <b>123.5</b>  |

Referuar tendencës së rritjes së vazhdueshme të kërkesës për ujë, si dhe problematikat e pritshme të rezervave ujore për shkak të ndryshimeve klimatike duhet bërë një vlerësim i këtyre rezervave në krahasim me plotësimin e kërkesës për ujë, të paktën asaj aktuale. Për këtë qëllim në tabelën 2, krahas volumit të ujit të prodhuar dhe konsumit për popullsinë e shërbyer jepen dhe burimet ujore respektive dhe kapacitetet e tyre.

**Tabela 2** Konsumi i Faturuar për Konsumatorët Familjare dhe Disponibiliteti i Burimeve

| Sh .R. UK Dibër | Popullsia e Shërbyer* | Uji i Prodhuar që futet në sistem (në m <sup>3</sup> ) | Konsumi Total i Matur dhe Aforfe (l/ditë, banor) | Popullsia e Regjistruar në Zonën e Shërbimit* | Kapaciteti i Burimit (në m <sup>3</sup> /vit) | Sasia e Disponueshme e Ujit (l/ditë, banor) | Diferenca në Plotësimin e Kërkesës (l/ditë, banor) |
|-----------------|-----------------------|--|--|---|---|---|--|
| <b>Dibër</b>    | 28,463                | 2,842,000  | 126.6  | 47,833  | 5,676,480                                     | 325.1                                       | +198.5   |
| <b>Mat</b>      | 18,660                | 1,959,000  | 109.1  | 21,424  | 3,153,000                                     | 403.2                                       | +294.1   |
| <b>Bulqizë</b>  | 18,000                | 1,722,127  | 126.7  | 24,225  | 4,158,598                                     | 470.3                                       | +343.6   |
| <b>Klos</b>     | 6,054                 | 810,000  | 143.9  | 12,898  | 1,224,000                                     | 260   | +116   |
| <b>Totali</b>   | <b>71,177</b>         | <b>7,333,127</b>                                       | <b>123.5</b>                                     | <b>106,380</b>                                | <b>14,212,078</b>                             | <b>366.0</b>                                | <b>+242.5</b>                                      |

\* Popullsia në juridiksion u korrigjua duke u bazuar në të dhënat e INSTAT-it të publikuara në rang qarku në Janar të vitit 2023 ndërsa për popullsinë në shërbim si bazë për llogaritje shërbeu mbulimi me shërbim i raportuar nga vetë shoqëritë UK.

Nga tabela 2, shihet se shoqëria rajonale UK Dibër ka burime të mjaftueshme ujore për plotësimin e kërkesës për ujë në zonën e saj të shërbimit pasi ka në total një sasi të disponueshme 366 l/ditë, banorë. Në fokusin e shoqërisë rajonale duhet të jetë mbrojtja e burimeve nëpërmjet shfrytëzimit me efikasitet të burimeve ujore të disponueshme, duke u bazuar në prodhimin sipas kërkesës për ujë si dhe reduktimin e humbjeve ujit në të gjitha njësitë përbërëse për të arritur dhe qëllimin final “kohëzgjatje të furnizimit me ujë në 24/7” për çdo njësi furnizimi.

## II.1 UPA për Ish Shoqërinë UK Dibër

Gjatë vitit 2022, ish shoqëria UK Dibër ka raportuar 2 842 000 m<sup>3</sup> ujë të prodhuar të vlerësuar, **pasi asnjë nga burimet e shfrytëzueshme nuk është i pajisur me aparat ujëmatës**. Raportohen 10,442 lidhje uji prej të cilave 6,324 lidhje ose 61% janë me matje. Shërbimin e furnizimit me ujë e marrin rreth 39,7 % të popullsisë në juridiksion.

“UPA” është në nivelin 46,06 %. Rrjeti shpërndarës i furnizimit me ujë nuk është i organizuar i gjithi në zona të pavarura me matje (DMA), për rrjedhojë monitorimi i humbjeve nuk mund të bëhet i detajuar sipas DMA-ve, por në tërësi për të gjithë sistemin. Kjo gjendje vështirëson monitorimin efikas të humbjeve dhe njëkohësisht bëhet pengesë gjatë ndërtimit të strategjive për zvogëlimin e humbjeve me orientim prioriteti në DMA-të më problematike.

Në tabelën 3, paraqitet bilanci i ujit si dhe komponentët përbërës të tij për ish shoqërinë UK Dibër.

**Tabela 3. Bilancit i Ujit për Ish Shoqërinë Dibër- Viti 2022.**

| Emërtimi   | Volumi i Ujit<br>(ne m <sup>3</sup> ) | Ndaj Ujit të Prodhuar<br>(ne%) |
|--|---------------------------------------|--------------------------------|
| Volumi i ujit të prodhuar që futet në sistem                     | 2,842,000                             | 100.00%                        |
| Konsumi i ujit të faturuar i matur                               | 1,083,000                             | 38.11%                         |
| Konsumi i ujit të faturuar i pa matur                            | 450,000                               | 15.83%                         |
| <b>Faturimi Total</b>  | <b>1,533,000</b>                      | <b>53.94%</b>                  |
| <b>Konsumi i Autorizuar i Pa faturuar</b>                        | <b>12,000</b>                         | <b>0.42%</b>                   |
| Humbjet e ujit nga lidhjet e paligjshme në linjën e transmetimit | 90,000                                | 3.17%                          |
| Humbjet e ujit nga lidhjeve e paligjshme në rrjetin shpërndarës  | 122,000                               | 4.29%                          |
| Humbjet e ujit nga pasaktësi në matjen e ujit, nën faturim etj.  | 290,000                               | 10.20%                         |
| <b>Humbjet e Dukshme (Administrative)</b>                        | <b>502,000</b>                        | <b>17.66%</b>                  |
| Humbjet e ujit nga rrjedhjet në linjat e transmetimit            | 190,000                               | 6.69%                          |
| Humbjet e ujit nga rrjedhjet në stacionin e pompave, burim.      | 80,000                                | 2.81%                          |
| Humbjet e ujit nga rrjedhjet dhe kapërderdhjet në depot e ujit   | 80,000                                | 2.81%                          |
| Humbjet e ujit nga rrjedhjet në rrjetin e shpërndarjes           | 430,000                               | 15.13%                         |
| Humbjet e ujit nga riparimet në linjat e sistemit të Ujësllësit  | 15,000                                | 0.53%                          |
| <b>Humbjet Reale (Teknike)</b>                                   | <b>795,000</b>                        | <b>27.97%</b>                  |
| <b>Humbjet Totale (Reale dhe të dukshme)</b>                     | <b>1,297,000</b>                      | <b>45.64%</b>                  |
| <b>UJI PA TË ARDHURA</b>   | <b>1,309,000</b>                      | <b>46.06%</b>                  |

### Komente mbi të dhënat e Tabelës 3:

- UPA në nivelin 46,06% të prodhimit vjetor.
- Volumi i ujit të prodhuar raportohet 100 % i vlerësuar.
- Niveli i humbjeve reale është 27,97%, ku shihet që pjesën më të madhe e zënë humbjet nga rrjedhjet në rrjetin shpërndarës 15,13% dhe në rrjetin e transmetimit 6.69 %, vlera e fundit konsiderohet veçanërisht e lartë. Shoqëria duhet të verifikojë nëse janë evidente çarje ose difekte mjaft të shpeshta të linjave të transmisionit, gjendje fizike të përkeqësuar dhe më problematike për tu marrë masa për uljen e këtyre humbjeve etj.
- Numri i klientëve me ujëmatës është 6,324 klientë dhe përbëjnë 61% të klientëve që përfitojnë këtë shërbim.

- Niveli i humbjeve të dukshme është 17.66% e volumit të ujit të prodhuar që futet në sistem, i cili vjen si rezultat i humbjeve nga lidhjet e paligjshme në nivelin 7.46% në transmetim dhe shpërndarje dhe në nivelin 10.2% janë humbjet nga pasaktësia në matje, nën faturim, të cilat konsiderohen të larta.
- Mungesa e matësve në prodhim nënkupton pasaktësi në përlogaritjen e sasisë së ujit të prodhuar, dhe njëkohësisht nivel të pabesueshëm të treguesit UPA.

### **Rekomandime:**

- *Duke patur parasysh që asnjë nga burimet e shfrytëzueshme nuk është i pajisur me aparat ujëmatës, nevoja për investime në ujëmatësa në prodhim është e domosdoshme dhe imediate. Shoqëria duhet të marrë masa për gjetjen e këtyre fondeve nga qeveria qendrore apo burimet e brendshme të saj për instalimin e tyre në mënyrë që të hartohet një bilanc uji sa më real.*
- *Ti kushtohet kujdes dhe rëndësi e veçantë volumit të ujit të prodhuar që përcaktohet me vlerësim, për t'ju afruar sa më shumë realitetit, deri sa të mundësohet prodhimi i matur në nivelin 100%.*
- *Në lidhje me përqindjen e lartë të humbjeve reale të cilat janë në nivelin 27.97%, që vijnë kryesisht nga rrjedhjet në rrjetin shpërndarës 15.13% dhe në rrjetin e transmetimit 6.69%, duhet të evidentohen nëse janë probleme të gjendjes teknike jo të mirë të rrjetit, të defekteve që ndodhin gjatë vitit, që të merren masa të gjenden fondet nga pushteti qendror ose vet shoqëria rajonale për rehabilitimin e tyre.*
- *Në lidhje me përqindjen që zënë humbjet që vijnë nga pasaktësia në matjen e ujit në prodhim dhe tek konsumatori dhe nën faturimi etj. të cilat janë në nivelin 10.2% të ujit të prodhuar, njësia duhet të thellohet në analizën për të përcaktuar se ku ekziston saktësisht problematika me ujin tek matësat apo tek nën faturimi duke kolauduar matësat/ndërruar matësat e vjetër, kontrolli i punës së lexuesve të matësve, a janë të pajisur me ujëmatësa shtëpitë private dhe kryesisht në zonat rurale etj.*
- *Shoqëria të shoh si prioritet ndarjen e rrjeteve të shpërndarjes në DMA të cilat mundësojnë monitorimin më të mirë të humbjeve, për të evidentuar ku janë problemet më të mëdha me humbjet, në bazë të të cilave do të hartohen planet e masave për zvogëlimin e tyre.*

## **II.2 UPA për Ish Shoqërinë UK Mat**

Shërbimi i furnizimit me ujë në Njësinë Administrative Mat ofrohet për 87.1% të popullsisë në juridiksion. Prodhimi vjetor i vlerësuar raportohet 1,959,000 m<sup>3</sup> ujë, **asnjë nga burimet e shfrytëzueshme nuk është i pajisur me aparat ujëmatës.** Numri i lidhjeve me ujin raportohet 6,639 lidhje, ku 4,575 lidhje 68.9% e tyre janë të pajisur me ujëmatës ndërsa pjesa tjetër faturohet aforfe. Faturimi i realizuar rezulton në nivelin 48.53% të prodhimit ndërsa “Uji Pa të Ardhura” është në nivelin 51.47%. Monitorimi i humbjeve në rrjetin shpërndarës nuk bëhet në bazë të DMA-ve.

Në Tabelën 4, paraqiten komponentët përbërës të Bilancit të Ujit për ish shoqërinë UK Mat.

**Tabela 4.** Bilanci i Ujit për Ish Shoqërinë UK Mat – Viti 2022

| Emërtimi  | Njësia               | Viti 2022        | Në % të Ujit të Prodhuar |
|---|----------------------|------------------|--------------------------|
| Volumi i ujit të prodhuar që futet në sistem                      | m <sup>3</sup>       | 1,959,000        | 100.00%                  |
| Konsumi i ujit të faturuar i matur                                | m <sup>3</sup>       | 655,491          | 33.46%                   |
| Konsum i ujit të faturuar i pa matur                              | m <sup>3</sup>       | 295,130          | 15.07%                   |
| <b>Faturimi Total</b>   | <b>m<sup>3</sup></b> | <b>950,621</b>   | <b>48.53%</b>            |
| <b>Konsumi i Autorizuar i Pa faturuar</b>                         | <b>m<sup>3</sup></b> | <b>2,500</b>     | <b>0.13%</b>             |
| Humbjet e ujit nga lidhjet e paligjshme në linjën e transmetimit  | m <sup>3</sup>       | 58,000           | 2.96%                    |
| Humbjet e ujit nga lidhjeve e paligjshme në rrjetin shpërndarës   | m <sup>3</sup>       | 112,500          | 5.74%                    |
| Humbjet e ujit nga pasaktësi në matjen e ujit, nën faturim etj.   | m <sup>3</sup>       | 290,000          | 14.80%                   |
| <b>Humbjet e Dukshme (Administrative)</b>                         | <b>m<sup>3</sup></b> | <b>460,500</b>   | <b>23.51%</b>            |
| Humbjet e ujit nga rrjedhjet në linjat e transmetimit             | m <sup>3</sup>       | 110,000          | 5.62%                    |
| Humbjet e ujit nga rrjedhjet në stacionin e pompave, burim.       | m <sup>3</sup>       | 60,000           | 3.06%                    |
| Humbjet e ujit nga rrjedhjet dhe kapërderdhjet në depot e ujit    | m <sup>3</sup>       | 60,000           | 3.06%                    |
| Humbjet e ujit nga rrjedhjet në rrjetin e shpërndarjes            | m <sup>3</sup>       | 310,379          | 15.84%                   |
| Humbjet e ujit nga riparimet në linjat e sistemit të Ujësjellësit | m <sup>3</sup>       | 5,000            | 0.26%                    |
| <b>Humbjet Reale (Teknike)</b>                                    | <b>m<sup>3</sup></b> | <b>545,379</b>   | <b>27.84%</b>            |
| <b>Humbjet Totale (Reale dhe të dukshme)</b>                      | <b>m<sup>3</sup></b> | <b>1,005,879</b> | <b>51.35%</b>            |
| <b>UJI PA TË ARDHURA</b>  | <b>m<sup>3</sup></b> | <b>1,008,379</b> | <b>51.47%</b>            |

**Komente mbi të dhënat e Tabelës 4:**

- UPA në vlerën prej 51.47% konsiderohet në nivele të pakënaqshme.
- Volumi i ujit të prodhuar raportohet 100 % i vlerësuar.
- Numri i klientëve me ujëmatës është 4,575 lidhje dhe përbëjnë 68.9% të klientëve që përfitojnë këtë shërbim.
- Humbjet administrative në nivelin 23.51% të prodhimit shkaktohen kryesisht nga lidhjet e paligjshme në rrjetin shpërndarës 5.74% dhe nga pasaktësi në matjen e ujit, nën faturimi etj. 14.8%. Këto të fundit konsiderohen sidomos mjaft të larta dhe të papranueshme.
- Niveli i humbjeve teknike 27.84%, vjen kryesisht nga rrjedhjet në rrjetin shpërndarës 15.84% dhe atë të transmetimit 5.62%, janë në kufijtë e vlerave që konsiderohen të pranueshme. Gjithsesi Shoqëria duhet të analizojë situatën në terren për mundësinë e uljes së tyre.
- Pasaktësia e mundshme gjatë përlllogaritjes të sasisë së ujit të prodhuar duke qenë se shoqëria nuk ka matësa në prodhim, vë në dyshim vërtetësinë e vlerës absolute të volumit të ujit të prodhuar dhe njëkohësisht nivel të pabesueshëm të treguesit UPA.

**Rekomandime:**

- Duke patur parasysh që asnjë nga burimet e shfrytëzueshme nuk është i pajisur me aparat ujëmatës, nevoja për investime në ujëmatësa në prodhim është e domosdoshme dhe imediate. Shoqëria duhet të marrë masa për gjetjen e këtyre fondeve nga qeveria qendrore apo burimet e brendshme të saj për instalimin e tyre në mënyrë që të hartohet një bilanc uji sa më real.
- Ti kushtohet kujdes dhe rëndësi e veçantë volumit të ujit të prodhuar që përcaktohet me vlerësim, për t'ju afruar sa më shumë realitetit, deri sa të mundësohet prodhimi i matur në nivelin 100%.

- Në lidhje me përqindjen që zënë humbjet që vijnë nga pasaktësia në matjen e ujit në prodhim dhe tek konsumatori dhe nën faturimi etj. të cilat janë në nivelin 14.8 % të ujit të prodhuar, njësia duhet të thellohet në analizën për të përcaktuar se ku ekziston saktësisht problematika me ujin tek matësat apo tek nën faturimi duke kolauduar matësat/ndërruar matësat e vjetër, kontrolli i punës së lexuesve të matësive, a janë të pajisur me ujëmatës shtëpitë private dhe kryesisht në zonat rurale.
- Në lidhje me përqindjen e lartë të humbjeve reale të cilat janë në nivelin 27.84%, që vijnë kryesisht nga rrjedhjet në rrjetin shpërndarës 15.84% dhe në rrjetin e transmetimit 5.62%, duhet të evidentohen nëse janë probleme të gjendjes teknike jo të mirë të rrjetit, të defekteve që ndodhin gjatë vitit, që të merren masa të gjenden fondet nga pushteti qendror ose vet shoqëria rajonale për rehabilitimin e tyre.
- Shoqëria të shoh si prioritet ndarjen e rrjeteve të shpërndarjes në DMA të cilat mundësojnë monitorimin më të mirë të humbjeve, për të diagnostikuar ku janë problemet më të mëdha me humbjet, në bazë të të cilave do të hartohen planet e masave për zvogëlimin e tyre.

### II.3 UPA për Ish Shoqërinë UK Bulqizë

Shërbimi i furnizimit me ujë në Njësinë Administrative Bulqizë ofrohet për 54.5% të popullsisë në juridiksion. Prodhimi vjetor raportohet i vlerësuar dhe në sasinë 1,722,127 m<sup>3</sup> ujë, **asnjë nga burimet e shfrytëzueshme nuk është i pajisur me aparat ujëmatës.**

Nga raportimi i të dhënave, faturimi rezulton 59.48% e prodhimit, ndërsa “Uji Pa të Ardhura” në nivelin 40.52%. Ish shoqëria UK Bulqizë ka në administrim 5,856 lidhje me ujin, ku 1,549 lidhje ose 26.45% e tyre faturohen me matje dhe pjesa e tjetër aforfe. Monitorimi i humbjeve në rrjetin shpërndarës nuk bëhet në bazë të DMA-ve.

Në Tabelën 5, paraqiten komponentët përbërës të Bilancit të Ujit për ish shoqërinë UK Bulqizë.

**Tabela 5.** Bilanci i Ujit për Ish Shoqërinë UK Bulqizë – Viti 2022

| Emërtimi   | Volumi i Ujit (në m <sup>3</sup> ) | Ndaj Ujit të Prodhuar (ne%) |
|--|------------------------------------|-----------------------------|
| Volumi i ujit të prodhuar që futet në sistem                     | 1,722,127                          | 100.00%                     |
| Konsumi i ujit të faturuar i matur                               | 354,981                            | 20.61%                      |
| Konsum i ujit të faturuar i pa matur                             | 669,261                            | 38.86%                      |
| <b>Faturimi Total</b>  | <b>1,024,242</b>                   | <b>59.48%</b>               |
| <b>Konsumi i Autorizuar i Pa Faturuar</b>                        | <b>6,500</b>                       | <b>0.38%</b>                |
| Humbjet e ujit nga lidhjet e paligjshme në linjën e transmetimit | 41,339                             | 2.40%                       |
| Humbjet e ujit nga lidhjeve e paligjshme në rrjetin shpërndarës  | 44,116                             | 2.56%                       |
| Humbjet e ujit nga pasaktësi në matjen e ujit, nën faturim etj.  | 141,930                            | 8.24%                       |
| <b>Humbjet e Dukshme (Administrative)</b>                        | <b>227,385</b>                     | <b>13.20%</b>               |
| Humbjet e ujit nga rrjedhjet në linjat e transmetimit            | 85,000                             | 4.94%                       |
| Humbjet e ujit nga rrjedhjet në stacionin e pompave, burim.      | 30,000                             | 1.74%                       |
| Humbjet e ujit nga rrjedhjet dhe kapërderdhjet në depot e ujit   | 25,000                             | 1.45%                       |
| Humbjet e ujit nga rrjedhjet në rrjetin e shpërndarjes           | 320,000                            | 18.58%                      |
| Humbjet e ujit nga riparimet në linjat e sistemit të Ujësjetës   | 4,000                              | 0.23%                       |
| <b>Humbjet Reale (Teknike)</b>                                   | <b>464,000</b>                     | <b>26.94%</b>               |
| <b>Humbjet Totale (Reale dhe të Dukshme)</b>                     | <b>691,385</b>                     | <b>40.15%</b>               |
| <b>UJI PA TË ARDHURA</b>   | <b>697,885</b>                     | <b>40.52%</b>               |

### **Komente mbi të dhënat e Tabelës 5:**

- UPA rezulton në nivele të pakënaqshme dhe përbën 40.52% të prodhimit vjetor.
- Volumi i ujit të prodhuar raportohet 100 % i vlerësuar.
- Numri i klientëve me matës është 1,549 lidhje dhe përbëjnë 26.45% të klientëve që përfitojnë këtë shërbim.
- Numri i klientëve familjar me matës është 1,337 klientë ose 86.3% e klientëve me matës.
- Humbjet administrative në nivelin 13.2% të prodhimit shkaktohen kryesisht nga lidhjet e paligjshme në rrjetin shpërndarës dhe të transmetimit 4.96% dhe nga pasaktësi në matjen e ujit, nën faturimi etj. 8.24%.
- Niveli i humbjeve teknike 26.94%, vjen kryesisht nga rrjedhjet në rrjetin shpërndarës 18.58% dhe atë të transmetimit 4.94%, janë në kufijtë e vlerave që konsiderohen të larta. Shoqëria duhet të analizojë situatën në terren për mundësinë e uljes së tyre.
- Pasaktësia e mundshme gjatë përlllogaritjes të sasisë së ujit të prodhuar duke qënë se shoqëria nuk ka matësa në prodhim, vë në dyshim vërtetësinë e vlerës absolute të volumit të ujit të prodhuar dhe njëkohësisht nivel të pabesueshëm të treguesit UPA.

### **Rekomandime:**

- *Duke patur parasysh që asnjë burim furnizimi me ujë nuk është i pajisur me ujëmatës nevoja për investime në ujëmatësa në prodhim është e domosdoshme dhe imediate, shoqëria duhet të marrë masa urgjente për gjetjen e këtyre fondeve nga qeveria qendrore apo burimet e brendshme të saj për instalimin e tyre, në mënyrë që të hartohet një bilanc uji sa më real.*
- *Ti kushtohet kujdes dhe rëndësi e veçantë volumit të ujit të prodhuar që përcaktohet me vlerësim, për t'ju afruar sa më shumë realitetit, deri sa të mundësohet prodhimi i matur në nivelin 100%.*
- *Duke patur parasysh mangësitë dhe vështirësitë në raportimet e vlerave të Bilancit të ujit që ka demonstruar stafi i shoqërisë, është i domosdoshëm trajnimi i stafit, si dhe caktimi i një personi përgjegjës për monitorimin e humbjeve, saktësimin e të dhënave si dhe hartimin e bilancit të ujit për gjatë gjithë muajve të vitit.*
- *Në lidhje me përqindjen e lartë të humbjeve reale të cilat janë në nivelin 26.94%, që vijnë kryesisht nga rrjedhjet në rrjetin shpërndarës 18.58% dhe në rrjetin e transmetimit 4.94%, shoqëria duhet të analizojë situatën në terren, duhet të evidentojë nëse janë probleme të gjendjes teknike jo të mirë të rrjetit, të defekteve që ndodhin gjatë vitit, që të merren masa të gjenden fondet nga pushteti qendror ose nga fondet e veta të shoqërisë rajonale për rehabilitimin e tyre, e cila do të çonte dhe në reduktimin e ujit pa të ardhura.*
- *Shoqëria të shoh si prioritet ndarjen e rrjeteve të shpërndarjes në DMA të cilat mundësojnë monitorimin më të mirë të humbjeve, për të evidentuar ku janë problemet më të mëdha me humbjet, në bazë të cilave do të hartohen planet e masave për zvogëlimin e tyre.*



#### II.4 UPA për Ish Shoqërinë UK Klos

Në Njësinë Administrative Klos shërbimi i furnizimit me ujë ofrohet për rreth 46,9% të popullsisë në juridiksion. Prodhimi vjetor i vlerësuar raportohet në sasinë 810,000 m<sup>3</sup> ujë i cili **është 100% i vlerësuar**.

Treguesi i UPA rezulton në nivelin 57,78%. Konsumi i Autorizuar i Faturuar raportohet në nivelin 42,22%, ndërsa Konsumi i Autorizuar i pa Faturuar në nivelin 1,11% e prodhimit.

Shoqëria konsumon për nevojat e veta rreth 1% të ujit të prodhuar.

Numri total i lidhjeve për shërbimin e furnizimit me ujë raportohet 2,106 lidhje, nga të cilat rreth 1,119 lidhje ose 53,13% janë me matës, ndërsa pjesa tjetër faturohet aforfe.

Lidhjet e paligjshme raportohen të pranishme kryesisht në rrjetin shpërndarës me 7,53% ndërsa në rrjetin e transmetimit më pak se 1%.

Në Tabelën 6 paraqitet Bilancit te Ujit dhe komponentët përbërës të tij për ish shoqërinë UK Klos.

**Tabela 6.** Bilanci i Ujit për Ish Shoqërinë UK Klos – Viti 2022

| Emërtimi  | Volumi i Ujit<br>(në m <sup>3</sup> ) | Ndaj Ujit të Prodhuar<br>(në %) |
|---|---------------------------------------|---------------------------------|
| Volumi i ujit të prodhuar që futet në sistem                      | 810,000                               | <b>100.00%</b>                  |
| Konsumi i ujit të faturuar i matur                                | 156,000                               | 19.26%                          |
| Konsum i ujit të faturuar i pa matur                              | 186,000                               | 22.96%                          |
| <b>Faturimi Total</b>   | <b>342,000</b>                        | <b>42.22%</b>                   |
| <b>Konsumi i Autorizuar i Pa faturuar</b>                         | <b>9,000</b>                          | <b>1.11%</b>                    |
| Humbjet e ujit nga lidhjet e paligjshme në linjën e transmetimit  | 7,000                                 | 0.86%                           |
| Humbjet e ujit nga lidhjeve e paligjshme në rrjetin shpërndarës   | 61,000                                | 7.53%                           |
| Humbjet e ujit nga pasaktësi në matjen e ujit, nën faturim etj.   | 65,000                                | 8.02%                           |
| <b>Humbjet e Dukshme (Administrative)</b>                         | <b>133,000</b>                        | <b>16.42%</b>                   |
| Humbjet e ujit nga rrjedhjet në linjat e transmetimit             | 50,000                                | 6.17%                           |
| Humbjet e ujit nga rrjedhjet në stacionin e pompave, burim.       | 58,000                                | 7.16%                           |
| Humbjet e ujit nga rrjedhjet dhe kapërderdhjet në depot e ujit    | 60,000                                | 7.41%                           |
| Humbjet e ujit nga rrjedhjet në rrjetin e shpërndarjes            | 153,000                               | 18.89%                          |
| Humbjet e ujit nga riparimet në linjat e sistemit të Ujësjellësit | 5,000                                 | 0.62%                           |
| <b>Humbjet Reale (Teknike)</b>                                    | <b>326,000</b>                        | <b>40.25%</b>                   |
| <b>Humbjet Totale (Reale dhe të Dukshme)</b>                      | <b>459,000</b>                        | <b>56.67%</b>                   |
| <b>UJI PA TË ARDHURA</b>  | <b>468,000</b>                        | <b>57.78%</b>                   |

#### **Komente mbi të dhënat e Tabelës 6:**

- UPA në vlerën 57.78 % rezulton në nivele të pakënaqshme.
- Volumi i ujit të prodhuar raportohet 100 % i vlerësuar.
- Numri i klientëve me matës është 1,119 lidhje dhe përbëjnë 53.13% të klientëve që përfitojnë këtë shërbim.

- Numri i klientëve familjar me matës është 1,039 klientë ose 93% e klientëve me matës.
- Humbjet administrative në nivelin 16.42% të prodhimit shkaktohen kryesisht nga lidhjet e paligjshme në rrjetin shpërndarës 7.53% dhe nga pasaktësi në matjen e ujit, nën faturimi etj. 8.02%.
- Niveli i humbjeve teknike 40.25%, është i papranueshëm, vjen nga rrjedhjet në rrjetin shpërndarës dhe atë të transmetimit 25.06%, në stacionin e pompave 7.16% dhe nga rrjedhjet nga depot 7.41%. Shoqëria duhet të analizojë dhe të monitorojë situatën në terren.
- Pasaktësia e mundshme gjatë përlllogaritjes të sasisë së ujit të prodhuar duke qenë se shoqëria nuk ka matësa në prodhim, vë në dyshim vërtetësinë e vlerës absolute të volumit të ujit të prodhuar dhe njëkohësisht nivel të pabesueshëm të treguesit UPA.
- Humbjet e dukshme nga lidhjet e paligjshme në transmetim 0.86% duken jo të besueshme.
- Stafi paraqet vështirësi për monitorimin e humbjeve dhe hartimin e bilancit të ujit.

### **Rekomandime:**

- *Duke patur parasysh që asnjë burim furnizimi me ujë nuk është i pajisur me ujëmatës nevoja për investime në ujëmatësa në prodhim është e domosdoshme dhe imediate, shoqëria duhet të marrë masa urgjente për gjetjen e këtyre fondeve nga qeveria qendrore apo burimet e brendshme të saj për instalimin e tyre, në mënyrë që të hartohet një bilanc uji sa më real.*
- *Ti kushtohet kujdes dhe rëndësi e veçantë volumit të ujit të prodhuar që përcaktohet me vlerësim, për t'ju afruar sa më shumë realitetit, deri sa të mundësohet prodhimi i matur në nivelin 100%.*
- *Duke patur parasysh mangësitë dhe vështirësitë në raportimet e vlerave të Bilancit të ujit që ka demonstruar stafi i shoqërisë, është i domosdoshëm trajnimi i stafit si dhe caktimi i një personi përgjegjës për monitorimin e humbjeve, saktësimin e të dhënave si dhe hartimin e bilancit të ujit për gjatë gjithë muajve të vitit.*
- *Në lidhje me përqindjen e lartë të humbjeve reale në nivelin 40.25%, shoqëria duhet të analizojë situatën në terren, duhet të evidentojë nëse janë probleme të gjendjes teknike shumë të keqe të rrjetit, të monitorojë defekteve që ndodhin gjatë vitit dhe të merren masa për të gjendur fondet nga pushteti qendror ose të veta për rehabilitimin e tyre.*
- *Shoqëria të ketë si prioritet ndarjen e rrjeteve të shpërndarjes në DMA të cilat mundësojnë monitorimin më të mirë të humbjeve, për të evidentuar ku janë problemet më të mëdha me humbjet, në bazë të të cilave do të hartohen planet e masave për zvogëlimin e tyre.*

### **III Përmbledhëse e UPA për Shoqërinë Rajonale UK Dibër**

**Shoqëria Rajonale UK Dibër**, e krijuar nga bashkimi i ish shoqërive UK Dibër, Mat, Bulqizë dhe Klos, ka në juridiksion 106,380 banorë.

Mbulimi me shërbimin e furnizimit me ujë realizohet vetëm për 71,177 banorë ose 66.91% të popullsisë totale.

Numri i lidhjeve për shërbimin e furnizimit me ujë raportohet 25,043 lidhje, nga të cilat 13,567 lidhje ose 54,2% janë të pajisur me aparate ujëmatës

**Prodhimi vjetor është 7,333,127 m<sup>3</sup> dhe është 100% i vlerësuar**, nevoja për aparateve ujëmatës në pikat prodhuese është imediate për të gjitha burimet e shfrytëzueshme.

**Uji Pa të Ardhura** është në nivelin 47,5% të ujit që hyn në sistem dhe shoqëria faturon vetëm **3,849,863 m<sup>3</sup> ujë** ose **52.5%** të prodhimit.

Tabela 7, paraqet komponentët përbërës të Bilancit të Ujit për vitin 2022, për Sh. Rajonale UK Dibër.

**Tabela 7.** Bilanci i Ujit për Shoqërinë Rajonale UK Dibër – Viti 2022

| Emërtimi   | Volumi i Ujit (ne m3) | Ndaj Ujit të Prodhuar (ne%) |
|--|-----------------------|-----------------------------|
| Volumi i ujit të prodhuar që futet në sistem                     | <b>7,333,127</b>      | <b>100.00%</b>              |
| Konsumi i ujit të faturuar i matur                               | <b>2,249,472</b>      | 30.68%                      |
| Konsum i ujit të faturuar i pa matur                             | <b>1,600,391</b>      | 21.82%                      |
| <b>Faturimi Total</b>  | <b>3,849,863</b>      | <b>52.50%</b>               |
| <b>Konsumi i Autorizuar i Pa faturuar</b>                        | <b>30,000</b>         | <b>0.41%</b>                |
| Humbjet e ujit nga lidhjet e paligjshme në linjën e transmetimit | <b>196,339</b>        | 2.68%                       |
| Humbjet e ujit nga lidhjeve e paligjshme në rrjetin shpërndarës  | <b>339,616</b>        | 4.63%                       |
| Humbjet e ujit nga pasaktësi në matjen e ujit, nën faturim etj.  | <b>786,930</b>        | 10.73%                      |
| <b>Humbjet e Dukshme (Administrative)</b>                        | <b>1,322,885</b>      | <b>18.04%</b>               |
| Humbjet e ujit nga rrjedhjet në linjat e transmetimit            | <b>435,000</b>        | 5.93%                       |
| Humbjet e ujit nga rrjedhjet në stacionin e pompave, burim.      | <b>228,000</b>        | 3.11%                       |
| Humbjet e ujit nga rrjedhjet dhe kapërderdhjet në depot e ujit   | <b>225,000</b>        | 3.07%                       |
| Humbjet e ujit nga rrjedhjet në rrjetin e shpërndarjes           | <b>1,213,379</b>      | 16.55%                      |
| Humbjet e ujit nga riparimet në linjat e sistemit të Ujësjetës   | <b>29,000</b>         | 0.40%                       |
| <b>Humbjet Reale (Teknike)</b>                                   | <b>2,130,379</b>      | <b>29.05%</b>               |
| <b>Humbjet Totale (Reale dhe të Dukshme)</b>                     | <b>3,453,264</b>      | <b>47.09%</b>               |
| <b>UJI PA TË ARDHURA</b>   | <b>3,483,264</b>      | <b>47.50%</b>               |

**Komente mbi të dhënat e Tabelës 7:**

- Treguesi UPA në nivelin 47,5% të prodhimit vjetor, megjithëse nën mesataren e sektorit për të gjithë vendin konsiderohet e lartë dhe duhet përmirësuar.
- Niveli i matjes për faktorin “Uji i Prodhuar”, është zero, kjo e bën të pabesueshme të gjitha vlerat absolute të vëllimeve të ujit që janë komponentë të bilancit të ujit.
- Konsumi total i faturuar është në nivelin 52.5%, prej të cilit 21.82% është konsum i faturuar i pamatur.
- Numri i klientëve me ujëmatës është 13,367 klientë dhe përbëjnë 54.2% të totalit të klientëve që e marrin këtë shërbim, për një menaxhim korrekt të kërkesës për ujë.

- Niveli i humbjeve reale është 29.05% që vijnë kryesisht nga rrjedhjet në rrjetin shpërndarës dhe në rrjetin e transmetimit në nivelin 22.48%, si dhe rrjedhjet në stacionet e pompimit dhe në depo në nivelin 6.18%. Shoqëria duhet të japi argumenta të mëtejshme për justifikimin e tyre, të analizojë dhe të monitorojë situatën në terren për mundësinë e uljes së tyre.
- Niveli i humbjeve të dukshme është 18.04 % e volumit të ujit të prodhuar që futet në sistem, i cili vjen, si rezultat i humbjeve nga lidhjet e paligjshme në transmetim dhe shpërndarje në nivelin 7.31 % të prodhimit vjetor dhe humbjet nga pasaktësia në matje, nën faturim etj. në nivelin 10.73%.
- Vlerësimi dhe analiza e humbjeve nuk kryhet në mënyrë të vazhdueshme dhe në zona të ndara me matje (DMA) në të gjithë zonën e shërbimit të shoqërisë.
- Në përgjithësi stafi has mjaft vështirësi për monitorimin e humbjeve dhe hartimin e bilancit të ujit në të gjithë zonën e shërbimit

### **Rekomandime:**

- *Duke patur parasysh që asnjë burim furnizimi me ujë nuk është i pajisur me ujëmatës nevoja për investime në ujëmatës në prodhim është e domosdoshme dhe imediate, shoqëria duhet të marrë masa urgjente për gjetjen e këtyre fondeve nga qeveria qendrore apo burimet e brendshme të saj për instalimin e tyre, në mënyrë që të hartohet një bilanc uji sa më real.*
- *Të bëhen përpjekje për sigurimin e fondeve për të projektuar dhe zbatuar sisteme DMA në të gjithë zonën e shërbimit të shoqërisë që mundëson një monitorim, evidentim dhe marrjen e masave për uljen e humbjeve në sistemet e furnizimit me ujë, si dhe hartimin e një bilanci korrekt të ujit.*
- *Shoqëria duhet të gjejë fonde për të rritur përqindjen e konsumatorëve familjare me matës (me prioritet instalimin e matësve në shtëpitë private dhe kryesisht në zonat rurale) që ky tregues të jetë sa më afër nivelit 100%, për të mundësuar një menaxhim racional të kërkesës për ujë, si dhe minimizimin e humbjeve të dukshme, pavarësisht se ato raportohen në disa raste mjaft të ulta dhe të pabesueshme.*
- *Për humbjet reale që vijnë kryesisht nga rrjedhjet në rrjetin shpërndarës të cilat janë në nivelin 22.48%, duhet të evidentohen nëse janë probleme të gjendjes teknike jo të mirë të rrjetit dhe të planifikohen fonde nga shoqëria për rehabilitimin e tyre, e cila do të çonte dhe në reduktimin e treguesit të Ujit Pa të Ardhura.*
- *Në lidhje me përqindjen që zënë humbjet që vijnë nga pasaktësia në matjen e ujit në prodhim dhe tek konsumatori dhe nën faturimi etj. të cilat janë në nivelin 10.73% të ujit të prodhuar, njësia duhet të thellohet në analizën për të përcaktuar se ku ekziston saktësisht problematika me ujin tek matësat apo tek nën faturimi duke kolauduar matësat/ndërruar matësat e vjetër, kontrolli i punës së lexuesve të matësve.*
- *Të trajnojë vazhdimisht stafin teknik në programet kombëtare të humbjeve të ujit të organizuara nga SHUKALB dhe më gjerë, si dhe të caktojë një person përgjegjës për monitorimin, përpunimin dhe saktësimin e të dhënave të raportuara, për hartimin e bilancit të ujit për çdo DMA dhe për të gjithë zonën e shërbimit të shoqërisë rajonale.*

- *Të rrisë bashkëpunimin me ERRU-në për të tejkalkuar vështirësitë në hartimin e bilancit të ujit dhe të dorëzojë atë në kohë pranë ERRU-së. Bilanci i ujit duhet të dorëzohet çdo 6 muaj për të gjithë zonën e shërbimit të shoqërisë rajonale, duke filluar me vitin 2023, vërtetësia dhe saktësia e të dhënave të bilancit do të vlerësohet nga ERRU si penalitet ose bonus për shoqërinë raportuese. Të caktojë një person përgjegjës për monitorimin, përpunimin dhe saktësimin e të dhënave të raportuara.*